

# DËSHMORËT E GREIKOCIT

Revistë e SHFMU «Dëshmorët e Greikocit» - Greikoc

Nr. 11- Prill 2016 - Greikoc

*Urime 5 Prilli - Dita e shkollës!*



Jakup Kurtishaj



Hazir Selimaj



Avdyli Beqiraj



Haxhi Haxhaj



Sabit Lushaj



Zenel Curraj



Naser Tafaj



Safet Kicaj





## MJEKJA E ARDHSHME

Një ndër nxënëset, që është shembull në shkollën tonë është Rinesa Shahinaj, nxënëse e klasës V/1. Rinesa është më e mira në lëndën e gjuhës shqipe dhe letërsisë, por ka prirje edhe për lëndët e tjera. Merret edhe edhe me aktivitete të lira, që organizohen në kuadër të shkollës, si në grupin e recituesve, të muzikës etj. Ëndrra e saj për të ardhmen është vazhdimi i shkollimit. Ka dëshirë që veten ta shohë në shërbim të popullit me mantel të bardhë.

Për Rinesën me admirim flet edhe mësuesi i saj, Fikret Ramaj, i cili thotë se Rinesa përveç që është shembullore në mësim, dallohet edhe në sjellje. Rinesës i dëshirojmë suksese në të ardhmen dhe të na bëhet një mjekje e mirë!

*Elhame Zenelaj*

## DUATË BËHEM PEDIATRE

Sara Kicaj është nxënëse klasës V/2. Është njëra ndër nxënëset më të mira në klasë, por është shembullore edhe në sjellje. Ajo me kënaqësi i mëson të gjitha lëndët mësimore. E adhuron shumë lëndën e matematikës. Edhe lëndët e tjera i mëson dhe ka sukses të shkëlqyeshëm në të gjitha lëndët mësimore. Merret edhe me aktivitete të lira, që organizohen në shkollën tonë. Ka dëshirë të lexoj romane. Pasioni i saj i veçantë është leximi.

Fjalë të mira për Sarën ka edhe mësuesi i klasës, Sami Baraliu, i cili thotë se Sara është një rast i veçantë. Fëmijë i mirë në mësim dhe e sjellshme. Sara në të ardhmen dëshiron të bëhet një pediatre shembullore, për t'u dalë në ndihmë fëmijëve të vegjël. Sarës i urojmë shumë suksese dhe shëndet të mirë!

*Raza Spahiu*




## DËSHMORËT

Çdo dëshmor në këtë jetë  
U flijua për këtë shtet  
Që ta largonin armikun  
E ta sillnin lirinë e shumëpritur  
Këta zogj që fluturojnë  
Janë të gjithë dëshmorët tanë  
Që dhanë jetën për liri  
Për të shtrenjtën pavarësi  
Sot i gjithë populli ju kujton  
Poeti vargje u thurr  
Këngëtari me këngë u madhëron  
S'u harron Kosova kurrë!

*Elmedina Canaj, kl. VI/2*



*Redon Selimaj, kl. III/1*



## DËSHMORËT E GREIKOCIT

Revistë e shkollës fillore dhe të mesme të ulët  
“Dëshmorët e Greikocit”

### BOTUES:

Këshilli i shkollës

### REDAKTOR PËRGJEGJËS:

Fikret RAMAJ

### KOLEGJIUMI I REDAKSISË:

Tahir ZENELAJ

Haki BEQIRAJ

Raza SPAHIU

Ariana HAXHAJ, nxënëse

### BASHKËPUNËTORËT:

Sami BARALIU

Besim HALITAJ

Elhame ZENELAJ

Hashim KUKAJ

Ardhmërie BARALIU

Nasuf KRASNIQI

Mirela SELMANAJ, nxënëse

### KORREKTORË:

Merita KUKAJ

### SEKRETAR I REDAKSISË:

Haki HAZIRAJ

Realizimi kompjuterik në redaksinë  
e revistës “FIDANT”

Dorëshkrimet dhe fotot nuk kthehen.

## LEXUES TË NDERUAR,

*Të dashur lexues, në duar keni numrin e njëmbëdhjetë me radhë. Kjo është dëshmia më e mirë se ne pa hezitim po vazhdojmë të punojmë. Në emër të redaksisë i falënderoj të gjithë nxënësit dhe arsimtarët e shkollës sonë për bashkëpunim.*

*Për nxjerrjen e këtij numri një kontribut të pakontestueshëm dha edhe ushtruesja e detyrës së drejtorit, znj. Sevdije Krasniqi.*

*Gjithashtu, në emër të drejtorisë së shkollës, arsimtarëve dhe të gjithë nxënësve falënderoj nga zemra sponsorin gjeneral, Shoqatën “Greikoci”, e cila sponsorizoi këtë numër të revistës.*

*Jemi në prag të 5 prillit. Po festojmë Ditën e shkollës dhe njëkohësisht po përkujtojmë me krenari dëshmorët e fshatit tonë që ranë në altarin e lirisë.*

*Në emër të Redaksisë së revistës dhe në emrin tim personal të gjithë dëshmorëve të fshatit u shprehim ngushëllimet më të sinqerta për djemtë e tyre, të cilët dhanë jetën për lirinë që ne po e gëzojmë sot. U prefshin në paqe!*

*Të gjithë arsimtarëve, nxënësve, punëtorëve ndihmës të shkollës sonë ua uroj 5 prillin – Ditën e shkollës. Urime të gjithëve!*

*Fikret Ramaj*

### FALËNDERIM

*Drejtorja e shkollës, Këshilli i shkollës, si dhe redaksia e revistës falënderon nga zemra sponsorin gjeneral, Shoqatën “Greikoci”, që na ndihmoi për nxjerrjen e këtij numri.*

# PUNË DHE AKTIVITET I BEGATË NË SHËRBIM TË VENDLINDJES

### Themelimi i Shoqatës (maj 2015)

Më 17 maj 2015 në Spreitenbach të Aargaut zyrtarisht filloi veprimtarinë e saj Shoqata „Greikoci“. Në bazë të rrethanave dhe kërkesës së mërgimtarëve të fshatit Greikoc (komuna e Therandës) është marrë vendim të formohet një shoqatë humanitare, e cila synon përmirësimin e kushteve të jetesës po në këtë fshat.

Duke marrë parasysh, që shteti i ri i Kosovës i sapo formuar ka vështirësi serioze në plotësimin e kushteve primare jetësore të banorëve, mërgimtarët e Greikocit kanë marrë këtë iniciativë për t'i dalë në ndihmë fshatit të tyre në mirëmbajtjen e ambientit, infrastrukturën e fshatit, ambientet e kultit, aktivitetet sportive, ndihmë për familjet me nevojë etj. Shoqata do të funksionojë sipas statutit

të bazuar në ligjin zviceran (ZGB). Kryesia e Shoqatës do të bashkëpunojë me organet zyrtare të Zvicrës dhe ato të Kosovës.

Shoqata „Greikoci“ është komplet e pavarur dhe apolitike. Në tubimin themelues anëtarët e Shoqatës shfrytëzuan rastin për të zgjedhur simbolin e tyre. Në vijim pasojnë aktivitetet e Shoqatës „Greikoci“ për vitin 2015.



### Pastrimi i varrezave (qershor - korrik 2015)

Duke e pasur parasysh domosdoshmërinë për pastrimin e varrezave të fshatit, kryesia e Shoqatës „Greikoci“ më 28 qershor mori vendim, që të bëhet pastrimi i tre palë varrezave të fshatit Greikoc, duke e ndarë buxhetin e duhur për të ndërmarrë një aksion të tillë. Gjatë pushimeve verore, anëtarët e kryesisë: Emrush Lushaj dhe Blerim Haxhaj, në mënyrë vullnetare mbikqyrën punimet për pastrimin e varrezave. Punimet për pastrimin e varrezave përfunduan gjatë muajit korrik afër festës së Fitër Bajramit.

### Ndihma për 14 familje skamnore (korrik 2015)



Për nder të muajit të shenjtë të Ramazanit dhe festës së Fitër Bajramit, kryesia e Shoqatës vendosi që me mjetet e saj personale t'u dalë në ndihmë 14 familjeve skamnore të fshatit Greikoc, duke u dhuruar pako ushqimore.

### Nderim dëshmorëve të fshatit dhe promovimi i Shoqatës në Greikoc (gusht 2015)

Me 1 gusht 2015 Shoqata „Greikoci“ organizoi një tubim, ku bëri promovimin e objektivave të veta dhe nderoj dëshmorët e fshatit të rënë në luftën e fundit në Kosovë në vitet 1998/1999. Ky takim u mbajt në ambientet e shkollës fillore të fshatit Greikoc, ku ishin të ftuar kryetari i komunës dr. Sali Asllanaj, kryetari i fshatit Zeqir Kurtishaj, imami i fshatit mr. Lulzim Susuri; familjarë të dëshmorëve e përfaqësues të subjekteve politike në nivel fshati dhe qytetarë të ndryshëm. Ky manifestim u përcoll me këngë, valle dhe recitime nga nxënësit e shkollës fillore të fshatit Greikoc nën menaxhimin e arsimtarit, Fikret Ramaj.



### Takime me përfaqësues të komunës dhe të fshatit (gusht 2015)

Gjatë pushimeve verore, në gusht 2015, anëtarët e kryesisë shfrytëzuan rastin që t'i njoftojnë autoritetet e komunës dhe atyre të fshatit rreth veprimtarisë së filluar nga Shoqata „Greikoci“, ku diskutuan rreth bashkëpunimit të ndërsjellë në të ardhmen. Takimet u zhvilluan me drejtorin e urbanizmit Kushtrim Kicaj, kryetarin e fshatit, Zeqir Kurtishaj, si dhe me mbarë anëtarët e kryesisë së fshatit Greikoc.



## Shoqata „Greikoci“ - raport vjetor 2015

### Manifestimi për nder të ditës së flamurit (nëntor 2015)

Para se të përfundoi viti kalendarik 2015, kryesia e shoqatës „Greikoci“ me synim që t'i bashkojë mërgimtarët e Greikoci vendosi që të organizojë një manifestim për nder të ditës së flamurit, i cili u mbajt me 28 nëntor 2015 në Wettingen të Aargaut, ku ishin të ftuar anëtarë dhe jo anëtarë për ta përkujtuar këtë datë historike.

Në këtë manifestim morën pjesë mbi 350 shqiptarë nga të gjitha trevat. I pranishëm ishte edhe konsulli i Republikës së Kosovës në Zürich, Salih Sefa. Shoqata „Greikoci“ në bashkëpunim me aktorin e mirënjohur, Adem Kicaj organizuan një program të pasur kulturor-artistik. Ku morën pjesë këngëtarë të njohur, si: Naxhije Fejza, Emin Racaj, Isak Karaxha, si dhe këngëtarët nga Greikoci, që udhëtuan special për këtë manifestim: Naser Kicaj, Majlinda Kurtishaj, Fatmir & Hasan Kurtishaj.

Në shfaqjet teatrale për Besim Ndrecajn dhe Ismail Qemalin performuan artistët, si: Florim Kleçka, Ilmi Hajzeri, Doruntina Jahlezi dhe Adem Kicaj.

Shoqata „Greikoci“ falënderoi të gjithë pjesëmarrësit, artistët, ansamblin „Trojet“ nga Winterthuri, grupin e vallëzimit „Rinia“ nga Spreitenbach-u, që e hijeshuan me valle tradicionale shqiptare këtë manifestim.



### Ndihmë për familjen Canaj (dhjetor 2015)

Për gjestin e marrë nga Shoqata Shqiptaro-Islame Brugg AG – Zvicër për t'i dalë në ndihmë familjeve të Murat dhe Reshat Canaj nga fshati Greikoc, duke ndërtuar një shtëpi me kushte normale gjatë verës 2015, Shoqata „Greikoci“ vendosi që ta ndihmojë këtë organizatë me një shumë simbolike prej CHF 1000. Për aksionin e ndërmarrë nga Shoqata Shqiptaro-Islame Brugg - AG Zvicër, kryesia e shoqatës „Greikoci“ falënderoi aktivistët e kësaj organizate.

### Synimet për vitin 2016

Me rastin e përfundimit të veprimtarisë në vitin e parë, kryesia e Shoqatës „Greikoci“ falënderoi të gjithë anëtarët dhe miqtë për kontributin e dhënë në përkrahje të saj. Për vitin 2016, kryesia e Shoqatës ka vendosur, që të fokusohet në mirëmbajtjen e ambientit në fshatin Greikoc, duke e shpallur vitin 2016 si vit të ambientit. Projektet konkrete do të pasojnë gjatë pranverës së këtij viti.

Rreth Shoqatës „Greikoci“

Themelimi: 17 maj 2015

Selia: Kleindöttingen AG – Zvicër

Nr. i anëtarëve: mbi 130

Webfaqja: [www.greikoci.ch](http://www.greikoci.ch)

Kontakt: [shoqata\\_greikoci@gmx.ch](mailto:shoqata_greikoci@gmx.ch)

**Sedat Selimaj**

## Organizata “SYRI I PASTËR”

### PUNË VULLNETARE NË MBËSHTETJE TË SHKOLLËS

Oborri i pashfrytëzuar, mbeturinat e shumta, jo ndërgjegjësimi sa duhet i nxënësve janë disa nga problemet, me të cilat ballafaqohet shkolla jonë. Për evitimin e këtyre problemeve, u ndie e nevojshme formimi i një organizate, e cila do të veprojë në mbrojtjen e mjedisit të shkollës sonë. Inisiativën për formimin e kësaj organizate e morën nxënësit e klasës IX/1. Organizata u emërua “Syri i pastër” dhe vepron brenda hapësirës së shkollës sonë. Kryesia e kësaj organizate përbëhet prej katër vetash: **Zylfie Kicaj, Vlera Beqiraj, Mirela Selmanaj dhe Drenusha Kicaj**. Qëllimi i kësaj organizate është që të nxisë aktivitete dhe aksione, për të arritur ndryshime pozitive në shkollën tonë. Kjo organizatë ka për detyrë pastrimin (si brenda, ashtu edhe jashtë), mbjelljen e fidanëve, të luleve, të bredhëve etj. Motoja “Syri i pastër” është sensibilizimi, ndërgjegjësimi dhe veprimi i nxënësve për një ambient sa më të pastër. Por, të gjitha këto nuk mund të arrihen vetëm me katër

vetë. Kështu, nxënësit e shkollës sonë, kanë vendosur të na ndihmojnë në mbledhjen e fondeve, si dhe në pastrimin e shkollës. Ky veprim u bë vullnetarisht, pa u imponuar nga askush.

Në këtë aspekt ndihmë kanë dhënë edhe arsimtarët e shkollës sonë, të cilët e mirëpritën këtë iniciativë. Jemi marrë vesh, që gjatë kohës, kur bëjmë rregullimin e mjedisit t'i veshim bluzat e gjelbra, në mënyrë që të dallohemi prej të tjerëve. Shpresojmë se nxënësit tanë të vetëdijësohen se jeta në mjedis të papastër do të thotë dëmtim i shëndetit. Vetëm jeta në mjedis të pastër i ndihmon shëndetit tonë dhe njerëzve në përgjithësi.

Jemi shumë të bindur se të gjithë do të na ndihmojnë në zbulimin dhe shndërrimin e shkollës në mjedis të pastër, ashtu siç e dëshirojmë të gjithë. Na priftë e mbara!

**Vlera Beqiraj, Mirela Selmanaj,  
Zylfie Kicaj dhe Drenusha Kicaj**

**Dëshmorët e Greikocit**

*Historia e arsimit tonë është një histori luftash, përpjekjesh, histori e një populli të vogël në numër, por të madh në botën e tij shpirtërore, në vullnetin e tij për të qenë i lirë dhe i pavarur.*

**S**a do që mundohesh të thuash apo të shkruash për mësuesen Zelë, përsëri nuk do të mundesh të gjesh fjalë e shprehje, që mund t'i thuash të gjitha për punën e saj shembullore në procesin mësimor.

Mëseusja Zelë një pjesë të mirë të jetës ia kushtoi edukimit dhe arsimimit të brezave. Është nder dhe krenari për kolektivin e shkollës sonë të kemi në mesin tonë një mësuese të dalluar. Punon me përkushtim të madh, jo vetëm me nxënës, por edhe u ndihmon e i këshillon edhe të tjerët.

Mëseusja Zelë u lind më 1971 në Prizren. Shkollën fillore, të mesmen dhe SHLP-në i mbaroi në Prizren. Më vonë u diplomua në Fakultetin e Edukimit – gjuhë shqipe dhe letërsi.

Në arsim filloi të punojë që nga viti 1993. I takon asaj gjenerate arsimtarësh që punuan në kushte tejet të vështira të arsimit shqip.

Mëseusja Zelë është e admiruar dhe e respektuar nga të gjithë: nga nxënësit, nga prindërit, e në veçanti nga kolegët e punës. Ajo duhet të ndjehet krenare për të gjitha ato që i bëri në procesin edukativo-arsimor.

Fjalët që i flet janë këshilluese, kuptimplote dhe me domethënie të veçantë.



*Zeliye Lushaj*

Në punën e saj gjithmonë i dha prioritet procesit mësimor, duke u bërë me dije të gjithëve, por edhe nxënësve të saj se edukata e shëndoshë dhe sjelljet e mira njeriun e bëjnë më të bukur.

Në këtë vit shkollor (2015/16) u zgjodh mësuesja më e mirë e shkollës dhe për nder të 7 Marsit – Ditës së mësuesit u nderua me mirënjohje nga Drejtoria Komunale e Arsimit e Therandës.

Në fund, mësueses Zelë i dëshirojmë sukses në punën e saj të mëtejme dhe mbi të gjitha shëndet.

*Fikret Ramaj*



**NJË MËSUES I MIRË DUHET TË KETË FORMIM KULTUROR E GJUHËSOR**

*Mësuesja Besë u lind më 1985. Ka mbaruar Fakultetin e Edukimit – Programin fillor në Universitetin e Prishtinës – qendra në Prizren. Ka titullin bachelor i programit fillor. Në procesin mësimor ka filluar të punojë që nga shtatori i vitit 2008. Ajo me kënaqësi ka pranuar që t'i përgjigjet pyetjeve tona.*

**D. E GREIKOCIT:** *Kush është mësuesja Besë?*

**BESA BEQIRAJ:** Kam lindur më 1985 në Prizren. Jam rritur pranë familjes. Shkollën fillore e kam mbaruar në vendlindje, kurse të mesmen në Suharekë. Më pas kam mbaruar edhe Fakultetin e Edukimit – Programin fillor në Universitetin e Prishtinës – qendra në Prizren.

Përhapjen e diturisë e fillova në vendlindjen time, ku edhe sot gjendem në mesin e filizave, që po rriten këtu në vendin që më tërheq kujtimet më të mira të jetës sime. Jo kushdo mund të bëhet mësues! Një mësues i mirë duhet të ketë formim kulturor e gjuhësor të gjerë, sepse ai është hallka kryesore e veprimtarisë në shkollë.

**D. E GREIKOCIT:** *Çka mund të na thoni për punën tuaj në arsim?*

**BESA BEQIRAJ:** Të jesh mësues është diçka e shenjtë, duke ditur që i gjithë shteti varet nga gjenerata e re, e cila është në dorën e mësimit, që edukohet, arsimohet dhe përgatitet për jetë. Mësuesi ka shumë role: prind, mjek, këshillues... Thënë shkurt e dua punën që bëj. Nuk është vetëm profesion, por edhe pasion.

**D. E GREIKOCIT:** *A mund të na tregoni për ndonjë mësues tuajin që u ka lënë mbresa, por në të njëjtën kohë të na veçoni ndonjë nxënës tuajin?*

**BESA BEQIRAJ:** Prej mësuesve kam shumë që më kanë lënë mbresa. Por, e kisha veçuar mësues Misinin, i cili ka qenë



**Besa Beqiraj**

punëtor i jashtëzakonshëm. Gjithashtu, ka qenë njohës i mirë i arsimit në përgjithësi. Ishte i afërt dhe tepër i sinqertë, i dashur për të gjithë. Puna dhe vepra e tij do të jenë udhërrëfim për ne.

**D. E GREIKOCIT:** *Sa ka autoritet mësuesi i sotëm?*

**BESA BEQIRAJ:** Në të kaluarën mësimit, mësuesi ka qenë i vetmi burim informacioni dhe ka ruajtur autoritetin e vet, duke qenë një mësues autoritativ. Ndërkaq, sot gjërat kanë ndryshuar, sepse e drejta e nxënësve është që të shprehin të lirshëm, me parafrazu dhe me i dhënë idetë veta, pastaj me bashkëpunuar dhe bashkëvepruar me shokun.

Mësuesi duhet të jetë autoritativ, por edhe tolerant e shok me nxënësin, sepse ata

duhet të mësojnë me dëshirë, që të arrijnë diç në jetën e tyre. Pastaj ta duan librin, ta kenë pasion leximin. Nxënësit duhet të respektojnë personalitetin e mësuesit dhe anasjelltas.

**D. E GREIKOCIT: Dy-tri fjalë për punën e sotshme?**

**BESA BEQIRAJ:** Sot e kemi shumë më lehtë të jemi mësimdhënës të mirë, duke marrë parasysh informacionet, teknologjinë, bashkëpunimin, tolerancën, e cila është prezente edhe nga mësuesi, por edhe nga nxënësi.

**D. E GREIKOCIT: Sot po mbahen seminare e kurse të ndryshme, me qëllim të ngritjes së performances së mësuesit. Diçka më tepër rreth kësaj...**

**BESA BEQIRAJ:** Këto seminare janë të mirëpritura dhe mjaft efektive. Në bazë të këtyre trajnimeve, mësimdhënia kaloi nga tradicionalja në atë bashkëkohore. Tash i kemi nxënësit në qendër e mësuesi konsiderohet si faktor subjektiv, sepse punën më të madhe e kryejnë nxënësit në bashkëpunim me mësuesin, duke u shprehur lirshëm. Mendoj se jemi në rrugë të mbarë. Mësimi i përcjell me emocion është më jetëgjatë! Nga trajnimet përfitojmë njohuri në fushën e mësimdhënies dhe të të nxënës, por edhe marrim kredi, të cilat janë të detyrueshme për licencim.

**D. E GREIKOCIT: Ndonjë moment gëzimi e dëshpërimi...**

**BESA BEQIRAJ:** Moment gëzimi e kisha theksuar ditën e parë kur fillova punën. Ishte një ditë e papërshekrueshme. E momente dëshpërimi nuk kam shumë, hahahah, por edhe s'kisha dashur t'i kujtoj...

**D. E GREIKOCIT: Dy-tri fjalë për**

**revistën e shkollës sonë.**

**BESA BEQIRAJ:** E përgëzoj redaksinë e revistës sonë, e në veçanti, mësues Fikretin, të cilit i takon e gjithë merita, sepse bënë një punë të palodhshme dhe me plot vullnet. Përmes revistës pasqyrohet puna mësimore dhe aktivitetet e lira në kuadër të shkollës.

Redaksisë i uroj punë të mbarë dhe suksese!

**D. E GREIKOCIT: Mesazhi juaj për Ditën e shkollës.**

**BESA BEQIRAJ:** Mësuesi e formon personalitetin e nxënësit. Ata janë në formim e sipër. Çdo vepër e çdo sjellje jona është shembull.

**D. E GREIKOCIT: Faleminderit për bisedë.**

**BESA BEQIRAJ:** Me nder qofshi dhe faleminderit edhe nga ju!

**Biseduan: Fikret Ramaj  
dhe Sami Baraliu**

## NËNA IME

Ajo më rriti  
Më dha dashuri  
Në prehër të saj  
Isha më i lumturi fëmijë.

Në prehër të saj  
Gjithë këto vite i kalova  
Shumë gjëra të reja  
Prej saj i mësova.

Sot nëna ime e dashur  
Të gjitha këto i kujtoj  
Nga thellësia e shpirtit tim  
8 marsin ta uroj.

**Ajet Kicaj, kl. III/1**



## ANKETË ME NXËNËSIT E KLASAVE TË NËNTA

# E ARDHMJA MUND TË ARRIHET ME PUNË E PËRKUSHTIM

*Duke pasur parasysh faktin se nxënësit e klasave të nënta janë para përfundimit të klasës së nëntë, vendosëm që të bëjmë një anketë me ta, lidhur me përcaktimin e tyre për më tutje. Ata pranuan me kënaqësi që t'i pëgjigjen pyetjes së Redaksisë së revistës sonë: "Çka pas klasës së nëntë?"*

### MIRELA SELMANAJ:



Është një ndjenjë e papërshkrueshme, kur më kujtohet se u ula për herë të parë në këto banka shkollore. Sa shpejt kaluan vitet, kurse tash është koha, që të ulemi e të mendojmë seriozisht për gjërat e së ardhmes dhe për sfidat e jetës. Pa dyshim, se një njeri shfrytëzon veten në

maksimum për të arritur atë çfarë do. Tash erdhi ajo kohë, të cilën e kam ëndërruar gjatë gjithë jetës sime. Erdhi koha që t'i hap dyert e jetës sime e të vendos edhe unë për të ardhmen që më pret. Shkollimin, shpresoj ta vazhdoj në gjimnaz. Ky është synimi im për momentin.

Si të gjithë të tjerët edhe unë kam një ëndërr për të ardhmen. Ëndërroj që të bëhem aktore. Si e vogël kisha këto preferenca. Gjithnjë imitoja njerëzit. Do të jap gjithçka nga vetja për ta realizuar këtë ëndërr!

### GËZIM TAJ:



Ishte një ndjenjë e papërshkrueshme të jesh nxënës i shkollës sonë. Tash jemi në përfundim të klasës së nëntë. Kam kaluar mirë me të gjithë. Pasi që tash jemi në fund të klasës së nëntë i erdhi koha edhe asaj që të zgjedh për të ardhmen time. Dëshira ime është që të vazhdoj gjimnazin,

konkretisht drejtimin e shkencave natyrore. Ky gjimnaz gjithmonë ka nxjerrë nxënës të dalluar, të cilët më pas kanë vazhduar edhe fakultetin.

Pra, unë mendoj që, pasi ta përfundoj gjimnazin t'i vazhdoj studimet në arkitekturë. Kjo është dëshira ime.

### DRENUSHAKICAJ:



Njeriu pa pasur mundësinë e shkollimit nuk mund ta gjejë veten se çka është i aftë për të bërë. Çdo kush ka një ëndërr për të ardhmen e vet. Edhe unë si gjithë të tjerët kam një ëndërr. Dëshira ime që nga vegjlia është që të bëhem profesoreshë e gjuhës angleze. Edhe si lëndë e pëlqej gjuhën angleze. I

falënderoj të gjithë ata që më kanë ndihmuar, e posaçërisht falënderoj familjen time të mrekullueshme, që gjithnjë janë kujdesur për mua.

### FATJON HAXHAJ:



Edhe unë si shumë të tjerë kam ëndërrat e mia. Mendoj të vazhdoj në shkollën e mesme të mjekësisë në Prizren. Ëndërra ime është që të bëhem mjek, e më konkretisht stomatolog. Një falënderim për gjithë stafin e mësimdhënësve. Gjithashtu, ndihem krenar me familjen time, që vazhdimisht më

inkurajoi që unë të mësoj dhe të bëhem i sjellshëm. Në të ardhmen do t'ua shpërblej me sukses e punë këtë të mirë familjes sime.

### GETUART KICAJ:



Secili nga ne me punë e përkushtim mundohemi që të realizojmë dëshirat tona. Edhe unë jam në prag të përfundimit të klasës së nëntë, me shpresë se do ta realizoj ëndërrën time. Që nga fëmijëria kisha dëshirë që të bëhem një futbollist i suksesshëm. Shpresoj se me punë e përkushtim ta realizoj këtë ëndërr të kahmotshme.

## ANKETË ME NXËNËSIT E KLASAVE TË NËNTA

### DIELLËZACANAJ:



Erdhi koha të mendojmë për më tutje. Edhe këtij viti po i vjen fundi, me shpresë se në të ardhmen t'i drejtojmë forcat tona në profesionin që e pëlqejmë. Ky vit më bën të mendoj më shumë për atë se çfarë na pret pas shkollës fillore. Gjithmonë e kam pyetur veten se cila është e ardhmja ime e afërt. E ardhmja ime është në shkollën e mesme të mjekësisë, pra dua të

bëhem mjek. Ky profesion më bën që të kem një qëllim: "T'i shëroj ata që kanë nevojë për mua. T'u jap mundësi të gjithëve që ta vazhdojnë jetën. Dua ta mësoj Betimin e Hipokratit dhe t'i përmbahem atij Betimi deri në maksimum". Mirëpo, kjo dëshirë imja kërkon mund dhe përkushtim të madh. Andaj, gjithmonë ka kohë për të mësuar diçka të re.

### VJOSA KICAJ:



Çdo gjë ka fillimin, por edhe fundin. I erdhi fundi edhe shkollës fillore sa hap e mbyll sytë. Secili prej nesh ka momente të bukura. Pesë vjet i kaluam si fëmijë të vegjël, ndërsa katër të tjera të një moshe më madhore. Arsimitarët gjithnjë ishin të afërt me ne. Na mësonin dhe na këshillonin për të mirë. Ishin prind i dytë për ne. Erdhi koha që të përcaktohem për të ardhmen tonë – drejt një rruge me një të ardhme sa

më të mirë.

### ZYLFIE KICAJ:



E ardhmja është diçka që nuk dihet, por mund të arrihet. Gjithçka varet nga ne. Rruga për të arritur diçka është e vështirë dhe plot sfida. Ka pengesa, por ato nuk duhet të na ndalojnë për asnjë moment. Shpresoj se do t'ia arrij qëllimit tim. Dëshirat e mia për të ardhmen janë të shumta.

Kam vendosur që të regjistrohem në gjimnaz, në drejtimin e shkencave natyrore. Kjo më pëlqen më së shumti. Kurse sa i përket studimeve, ende nuk kam menduar, sepse nuk e di se cili profesion më përshtatet, por shpresoj se me kohë do të orientojem në atë që më pëlqen.

Shpresoj që edhe unë si gjithë të tjerët ta rregullojmë jetën, pa imponime.

### VLERABEQIRAJ:



Momentet e lumtura gjithmonë janë të shkurtra. Kështu, të paktën, mendojnë shumica e njerëzve. Edhe unë kam kaluar momente të mira, por edhe të këqia. Është viti i fundit së bashku me klasën time.

Tash erdhi koha që edhe unë të mendoj për të ardhmen time, e cila, shpresoj, që të më hap rrugët e drejta. Shkollimin do ta vazhdoj në gjimnaz, në drejtimin e shkencave natyrore. Shpresoj që ky drejtim të jetë i përshtatshëm për mua. E sa për profesionin tim në të ardhmen nuk e kam menduar ende, por shpresoj të jetë profesion, i cili do të më hap rrugët e suksesit.

### LEONORAKICAJ:



Po vjen fundi i vitit e bashkë me të po ikim dhe ne. Po lëmë pas vetëm disa kujtime dhe po fillojmë një jetë, krejtësisht të re. Tash duhet të vendosim se kush do të jemi në të ardhmen dhe çfarë na pret pas klasës së nëntë.

Që e vogël kisha dëshirë të mësoja dhe të bëhesha një mjek e dalluar. Shpresoj që me punë dhe me përkushtim ta realizoj

ëndrrën time.

### ARIANAHAXHAJ:



Tash jemi në prag të përfundimit të klasës së nëntë. Ëndrra ime është që një ditë të bëhem mjek, prandaj pas shkollës fillore do të vazhdoj në shkollën e mesme të mjekësisë, e gjithashtu, edhe studimet për mjekësi. Arsyeja se pse kam zgjedhur këtë profesion është se dua t'i ndihmoj të sëmurët dhe ta përparojmë vendin tonë.

Shpresoj se do t'ia arrij, sepse arsimiti të bën të ditur dhe të jep vlera të larta. Një mesazh shkon për të gjithë ata që po lexojnë këtë anketë: "Luftoni shumë, për të arritur diçka në jetë, sepse nuk duhet ta harrojmë mundin se çfarë kanë bërë dëshmorët, që ne sot të shkollohemi të lirë".

*I anketuan:  
Haki Beqiraj dhe Merita Kukaj*

**Dëshmorët e Grekocit**

**NJERËZIT ARSIMDASHËS SAKRIFIKUAN ÇDO GJË  
NGA VETJA PËR TË MIRËN E KËTIJ VENDI**



Vdekja e hershme e mësuesit Avdi Curri për të gjithë ne ishte një moment pikëllimi e dhembjeje. Ishte gjithmonë burrë i guximshëm, i matur, i urtë; ishte burrë i palodhshëm dhe plot optimizëm.

Mësuesi Avdi u lind më 14.1. 1954 në Greikoc. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Suharekë, kurse SHLP-në – drejtimi gjuhë shqipe dhe letërsi në Gjakovë.

Në procesin mësimor inkuadrohet në vitin 1981. Që nga janari i vitit 1985 ishte drejtor shkolle. Mandatin e drejtorit e përfundoi në vitin 1993. Ishte drejtor i parë i shkollës sonë – të pavarësuar nga shkolla e Gjinocit. Gjithashtu, ishte njëri ndër kontribuesit më të mëdhenj të pavarësimit të shkollës sonë.

Vdekja e hershme në vllugun më të madh të punës ishte një humbje e pakonpen-

sueshme, jo vetëm për familjen e tij, por edhe për mbarë kolektivin e shkollës sonë.

Tërë këtë rrugëtim jetësor ia kushtoi arsimit dhe edukimit shqip. Prandaj, puna dhe shembëlltyra e tij prej kolegu e mësimitdhënësi do të na ngelin të pashlyera në kujtesën e nxënësve dhe të kolegëve të tij.

Për të shkruar për mësuesin Avdi nuk është asnjëherë e tepërt. Për të gjetur fjalë për të, kur kihet parasysh se çka dha për shkollën dhe edukimin e brezave, nuk është edhe aq e lehtë. Jeta nuk ndërrohet me asgjë. Ajo është më e shtrenjta, më e vlefshme. Por, ja që njerëzit arsimdashës sakrifikuan çdo gjë nga vetja e tyre për të mirën e tyre – për të mirën e këtij vendi.

Avdi Curri ishte gjithnjë fjalëpak. Ai kishte durim të jashtëzakonshëm për të dëgjuar këshillat dhe sugjerimet e shokëve. Jepte mendime të pjekura e konkrete. Maturia dhe gjakftohtësia ishin karakteri i tij. Ishte i çiltër, i sinqertë me shokët dhe rrethin familjar. Ishte një bashkëshort i mirë, një baba shembullor. Respektonte familjen e tij, i donte jashtëzakonisht fëmijët, prandaj përpiquej t'i edukonte siç i ka hije një prindi që ngjallte respekt.

Fëmijët dhe nxënësit, për mësuesin Avdi, konsideroheshin si një e tërë e pandarë, që nuk mund të shkëputeshin për asnjë çast nga zemra e tij e madhe, nga zemra e tij përplot dashuri, nga zemra e tij përplot humanizëm. Nuk ka gjë më humane në këtë botë se shkëmbimi i dijes me nxënësit dhe kolegët. Këta njerëz tejkalojnë vetveten, tejkalojnë pragun e së mundshmes.

U nda nga ne ende pa i përfunduar notat e nxënësve. Gjithmonë do të kujtohet me pietet e krenari.

**QOFTË I PËRJETSHËM KUJTIMI  
PËR TË!**

*Fikret Ramaj*

# PUNË DHE AKTIVITETE

-Këtë vit shkollor u zgjodh Bordi i ri shkollës sonë, në përbërje të të cilit janë: Tahir Zenelaj, Merita Kukaj dhe Muhamet Kicaj, nga radhët e arsimtarëve; ndërkaq nga radhët e prindërve u zgjodhën: Reshat Selimaj, Isak Curraj dhe Ali Canaj.

\*  
\* \*

-Garat komunale të recituesve në Therandë do të mbahen më 15.4.2016 në shtëpinë e kulturës “Ukë Bytyçi”.

\*  
\* \*

-Më 1 mars 2016 u mbajt Testi për Olimpiadën e matematikës me nxënësit përfaqësues të shkollave. Në test morën pjesë 50 nxënës të klasave të nënta. Edhe nxënësit tanë përfaqësuan shkollën tonë denjësisht. Nxënësja, Vlora Beqiraj, tregoi sukses të lakmueshëm.

\*  
\* \*

-Kolegji “Mehmet Akif” në Prizren organizon kurse pa pagesë për lëndët: matematikë dhe gjuhë angleze për nxënësit e klasave të pesta dhe të teta. Këto kurse do të organizohen brenda 6 shkurtit 2016 deri më 7 maj 2016. Kurse mbahen me qëllim që t'u ndihmojë nxënësve në mësimet e tyre. Programi i kurseve do të zgjasë gjithsej 12 javë dhe në fund nxënësit do të pajisen me certifikata.

\*  
\* \*

-Këshilli i shkollës ka marrë vendim që të gjithë nxënësit dhe arsimtarët e shkollës sonë të bartin uniforma.

\*  
\* \*

-Mësuesja, Zelig Lushaj, u zgjodh mësuesja më e mirë e shkollës sonë dhe për nder të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit u nderua me mirënjohje nga Drejtoria Komunale e Arsimit të Therandës.

\*  
\* \*

-Më 17 shkurt 2016 për nder të tetëvjetorit të pavarësisë së Kosovës nxënësit e të dyja ndërrimeve përgatitën program kulturor-

argëtues, në shenjë nderimi dhe respekti për këtë datë të shënuar.

\*  
\* \*

-Më 8 mars 2016, nxënësit e klasës III/1 (klasa e mësueses Besa Beqiraj) përgatitën një program të begatë për nder të festës së nënës.

\*  
\* \*

-Nxënësit e klasave të nënta formuan një organizatë për mbrotjen e ambientit në shkollën tonë. Organizata u emërua “Syri i pastër”. Qëllimi i kësaj organizate është vetëdijësimi i nxënësve të shkollës sonë, për një ambient sa më të pastër.

\*  
\* \*

-Tre arsimtarë të shkollës sonë me mjaft sukses mbaruan studimet master. Arsimtarja, Ardhmërie Baraliu kreu studimet master në fushën e muzikës, kurse Sami Baraliu dhe Fikret Ramaj kryen studimet master në fushën e menaxhimit në arsim.

\*  
\* \*

-Shumë arsimtarë të shkollës sonë me mjaft sukses kryen kurset në menaxhimin e arsimit, që i organizon MASHT-i.

\*  
\* \*

-Për nder të 1 Qershorit – Ditës së Fëmijëve, në Therandë, do të mbahet program kulturor –argëtues. Në këtë program do të marrin pjesë, kryesisht, nxënësit e klasave të para dhe fëmijët parashkollorë. Edhe nxënësit e shkollës sonë do të paraqiten me disa pika në këtë manifestim.

\*  
\* \*

-Më 21 mars 2016 për Ditën e ambientit, nxënësit e shkollës sonë, në bashkëpunim me Eko regjionin, do të bëjnë pastrimin e shkollës, si dhe rrugët e fshatit.

*Kronisti i shkollës*

## PARISI SI ATRAKSION TURISTIK NË FRANCË

Parisi është kryeqyteti i Francës dhe krahinës së Ile-de-France (ishulli i Francës) dhe qyteti më i madh i Francës. Në tekstet e moçme latine Parisi emërohet edhe Lutetia apo Lutezia. Lumi Sena e ndan qytetin në dy pjesë. Pjesa veriore (rive droite „bregu i djathtë“) dhe pjesa jugore (rive gauche „bregu i majtë“). Parisi zyrtarisht numëron 2.138.551 banorë, ndërsa në krahinën e Parisit (région de l'Ile-de-France) jetojnë 11.564.680 banorë (Sipas vlerësimi të popullsisë të 1 janar 2005). Një vendbanim i rëndësishëm për më shumë se dy mijëvjeçarë, Parisi u bë, që nga shekulli i 12-të, një nga qendrat më kryesore të Evropës për arsimin dhe artet dhe qytetërim i madh në botën perëndimore deri në fillim të shekullit të 18-të.

Parisi ka pozitën e tij falë lumit Sena, që i bie qytetit mospërmas. Parisi, sot, është një nga qendrat kryesore të biznesit e të kulturës në botë dhe ndikimet e tij në politikë, arsim, argëtim, media, shkencë dhe arte kontribuojnë në statusin e tij, si një nga qytetet globale më të mëdha në botë. Parisi dhe rajoni i Parisit, me 572,4 miliardë euro në vitin 2010, prodhon më shumë se një të katërtën e prodhimit të brendshëm bruto të Francës dhe si qytet ka një nga GDP-të më të mëdha në botë. Duke qënë një qytet me gjelbërim dhe i pëlqyeshëm për të jetuar, Parisi dhe rajoni i tij janë destinacioni kryesor turistik në botë. Ka katër vende të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe shumë organizata ndërkombëtare. Është thjeshtë e pamundur të vendosësh se çka duhet të vizitosh më parë në kryeqytetin francez, Parisin. Ajo që të gjithë e thonë është se atë e vizitojnë përmbi 40 milionë njerëz në vit. Por, janë pesë gjëra kryesore që të gjithë parisienët ua këshillojnë që t'i vizitoni. Tri nga monumentet më të famshme pariziane janë katedralja: **Notre Dame e Parisit e shekullit të 12-të, Harku i Triumfit dhe Kulla Eiffel.** Kulla Eifel ishte një konstruktion i "përkohshëm" nga Gustave Eiffel për Ekspozita Universale 1889, por kulla nuk u çmontua dhe tani është një simbol i përjetshëm i Parisit. Aksi historik është një linjë monumentesh dhe ndërtesash, që shtrihen në një linjë pothuajse të drejtë nga qendra e qytetit drejt perëndimit. Linja e monumenteve fillon me Muzeun e



*Parisi*

Luvrit dhe vazhdon për në Parqet Tuileries, Champs Elysees, Harkun e Triumfit dhe përfundon në rrethin e Sheshit të Etoile. Në 1960, linja u zgjat dhe më larg në perëndim te distrikti i biznesit La Defense. Muzeu i Invalidëve është vendi i varrimit për ushtarakët e mëdhenj francezë, duke përfshirë edhe Napoleonin dhe Kisha Pantheon është vendi ku janë varrosur shumica e grave dhe e burrave të shquar të Francës. Ish- Burgu Conciergerie mbante disa anëtarë të shquar të regjimit të vjetër para vdekjes së tyre gjatë Revolucionit Francez. Një tjetër simbol i Revolucionit janë dy statujat e Lirisë të vendosura në Ishullin Cygnestë Senës dhe në Parkun Luksemburg. Një version më i madh i statujave u dërgua si një dhuratë nga Franca në Amerikë, më 1886, dhe tani qëndron në Nju Jork. Në Pallatin Garnier, të ndërtuar në periudhën e Perandorisë së Dytë, ndodhen Opera e Parisit dhe Baleti i Parisit, ndërsa ish-pallati i Luvrit është tani një nga muzeumet më të njohura në botë. Sorbona është pjesa më e famshme e Universitetit të Parisit dhe ndodhet në qendër të Lagjes Latine. Përveç Notre Dame i Parisit, ka disa kryevepra të tjera kishtarë, duke përfshirë pallatin gotik të shërbimeve kishtarë të shekullit të 13-të Sainte-Chapelle dhe pallati i Eglise de la Madeleine. Për Francën dhe për Parsin rëndësi ka lidhja e Eurotunelit (lidhja nëntokësore) apo La Manshit i hapur në maj të vitit 1994, ku u lejon rreth 35 trenave të shpejtë Eurostar që e lidhin

për tre orë Londrën, Parisin e Brukselin në çdonjërin nga dy drejtimet, duke lidhur 9 terminale britanike më 20 kontinentale evropiane. Ky tunel ka modifikuar ekonominë dhe sjelljet e rajoneve. **Parisi ka diçka për të gjithë – kjo është një kapital në shumë aspekte, magjike, mitike dhe ndonjëherë për t'u habitur që është gjithmonë emocionuese.** Njerëzit vijnë në Paris dhe admirojnë trashëgiminë e tij të jashtëzakonshme arkitektonike dhe kulturore, duke e bërë atë një nga qytetet më të bukura në botë. Kjo trashëgimi

dinamike është vazhdimisht duke u përmirësuar dhe pasuruar. Një qytet ku diçka gjithmonë ndodh, Parisi është edhe kryeqyteti i gastronomisë, modës dhe pazareve. Ajo është e angazhuar për të mbështetur një cilësi të lartë të jetës dhe zhvillimit sustainable, duke ofruar banorëve të saj dhe vizitorëve një mjedis veçanërisht të këndshëm. Gjatë vizitës në Paris, në qytetin e romancës, mbi 300 ngjarje ndodhin çdo ditë në Paris, si: koncerte, ekspozita, shfaqje teatrale e ngjarje të panumërta të mëdha.

*Besim Halitaj, arsimtar i gjeografisë*

### E S E

## PRANVERA

*Pranvera është ndër stinët më të bukura dhe më të gëzueshme për të gjithë ne. Ajo fillon më 21 mars dhe mbaron më 22 qershor.*

*Në pranverë çelin lulet. Lulëzojnë pemët. Natyra gjlebëron dhe ndërron pamjen nga petku i bardhë i dëborës. Në këtë stinë ditët zgjaten, kurse netët shkurtohen, duke i falur më shumë lumturi fëmijëve. Njerëzit në këtë stinë fillojnë të vishen me rroba më të holla dhe me ngjyra më të hareshme. Dallëndyshet kthehen fluturimthi dhe fillojnë të zgjedhin shtëpitë për foletë e tyre.*

*Është kënaqësi, që të zgjohesh në mëngjesin e kësaj stine, me anë të cicërimave të këtyre zogjve kaq të mrekullueshëm.*

*Në këtë stinë moti fillon të nxehet dhe dielli del me rrezet e tij të arta, kurse qielli merr ngjyrë të kaltër dhe si zakonisht retë hapen ia lënë vendin disa reve plot me ngjyra dhe me forma të ndryshme.*

*Erblin Kurtishaj, kl. V/I*

## DASHURIA PËR PRINDIN ËSHTË SHUMË E RËNDËSISHME PËR MUA

*Çdo prindi nuk i mungon dashuria për fëmijën e tij. Jam shumë e sigurt se dashuria e tyre për ne nuk ka limit.*

*Këshillat e prindërve për të mirë më ngjasojnë me përkëdheljet, që merrja çdo sekondë kur isha e vogël, me atë zërin melankolik të mamit që më vinte në gjumë. Prindërit e mi janë gjithçka që unë kam. Ata janë të vetmit që më këshillojnë në mënyrën më të mirë, që mund të ekzistoj. Janë ilaçi i vetëm që mund të më shërojnë.*

*Familja ime është dhe do të mbetet gjëja më e shtrenjtë për mua. Prindërit e mi do të mbeten njerëzit më të mrekullueshëm në botë. Sakrificat, besimi, ndershmëria dhe drejtësia janë me të vërtetë gjërat që admiroj dhe vlerësoj më shumë te familja ime, duke shpresuar që dikur t'ua shpërblej.*

*Hajrie Shahinaj, kl. IX/I*

## JETA U TAKON ATYRE QË GUXOJNË

Unë çdo herë eci me hapa të sigurt, që i mësova nga familja ime. Edi sigurt dhe guximshëm. Jeta me të vërtetë i takon guximtarëve. Prandaj, nuk tërhiqem kurrë pa e bërë atë që dëshiroj. Gjithmonë thonë ose do të fitosh ose do të humbasësh. Epo nuk rrezikove, atëherë je humbës! Jeta është një libër i hapur, ku çdo ditë përpiqesh të lexosh të paktën një fletë. Asnjë rrugë nuk është e gjatë, nëse në fund të saj të pret diçka e bukur. E keqja poshtërohet nga e vërteta, injoranca përbuzet nga dituria, ndërsa të ligës i duken pendlat e saj të ngjyrosura, duke u përhumbur në greminën e harresës.

Jeta është vetëm një pasqyrë dhe atë që e sheh aty, duhet patjetër ta shohësh njëherë brenda vetes. Pavarësisht se çka ndodh me ne, bëje guximin ndaj vetes dhe mos lejo asnjëherë të dorëzohesh. Një ditë do të kuptosh se jeta me të vërtetë u takon guximtarëve. Jeta është një mësim i gjatë mbi nënshtrimin.

Arbnora Haxhaj, kl. IX/1

## FILLO T'I BËSH REALITET ËNDRRAT TUAJA

Ekziston gjithmonë një e nesërme. Jeta na jep mundësi që t'i bëjmë gjërat siç duhet, për të arritur diku. Në qoftë se bën gabime mbetet vetëm e sotmja ta sfidosh veten, e nesërmja humb. Në qoftë se sot shpreh atë se çfarë ke në mendje ta bësh, atëherë ke një shpresë se do t'ia arrish dhe e nesërmja është më e lehtë. Megjithatë, e nesërmja nuk është e sigurt për askë. Askush nuk mund t'i dijë mendimet e tua të fshehta. Kërko nga Zoti fuqi dhe sfido veten! Kërko zgjuarsi dhe shprehu!

Tregoj tu tjerëve se ke besuar në vetvete dhe ke arritur aty ku ke dashur. Tregoj domethënien e shumë gjërave. Thjesht trego se sa e bukur është jeta! Thuaje gjithmonë atë që e ndjen dhe bëje gjithnjë atë që mendon.

Atëherë fillo t'i bësh realitet ëndrrat tuaja. Tash është momenti!

Mirela Selmanaj, kl. IX/1

## ATDHEU IM

Atdheu është vendi ku robërohet shpirti. Atdheu nuk ka dashuri të cunguar. Ai që nuk bën gjithçka për Të, nuk bën asgjë. Atdheu s'mund të harrohet. Nuk ka sëmundje më fisnike se sa malli për atdheun. Vendi i huaj nuk të bëhet atdhe.

Në atdhe njeriu ka një të kaluar, por edhe të ardhme. Në vend të huaj ka vetëm të tashme. Atdheun e duam jo se është i madh apo i vogël, por e duam, sepse është yni. Vetëm në vend të huaj njej bukurinë dhe ëmbëlsinë e gjuhës amtare. Vetëm atje e ndjen se ç'është atdheu që e ke braktisur.

Vendlindja është vetëm një, ashtu sikurse nëna. Kujt i takon virtyti i mirë, atij i takon edhe atdheu.

Të vdesësh për atdhe, kjo është punë mbretërishe. Atdheu është si familja.

Rita Curraj, kl. V/1

## DËSHMORËT

Një popull që ka dëshmorë, nuk njej robëri.

Sytë e mi të mbuluar me pluhur nuk shihnin asgjë. Pastaj mjegulla e zezë, që kishte mbuluar vendin, filloi dalëngadalë të hiqej. Ç'të shihje?!

Maja e malit qëndronte prorre, ndërsa gjaku ridhte rrëqe, e mbi të fluturonte pëllumbi që sillte lirinë.

Dëshmorët që ranë për liri u bënë lule e luftës dhe e gjakut. Jo vetëm kaq, ata u bënë edhe shkronja të arta të lirisë, të ngulitura në zemrën e çdo shqiptari.

Vendin e përgjakur e mbulonin lotët, por thellë në zemër shfaqej gëzimi i paskaj. Nënlokja as nuk qante, as nuk rënkonte, por bekonte Shqipërinë, Kosovën dhe dëshmorët që ranë për liri.

Ne shqiptarët, me shekuj nuk e njohëm robërinë. Nuk thuhet kot se ku ka dëshmorë, nuk ka robëri. Dëshmorët tanë gjithmonë do të jetojnë në zemrat tona si fitimtarë.

Latife Lushaj, kl. IX/1



# KOPSHTI POETIK



## MËSUESJA IME

Mësuese e dashur  
Të falënderoj  
Sa do të jetë jeta  
S'do të të harroj.

Çdo ditë diçka të re  
Nga ti po mësoj  
Mendjen me dituri  
Po e pasuroj.

Mësimet dhe fjalët  
Kurrë s'i harroj  
Gjatë rrugës së jetës  
Do t'i kujtoj.

Shpresoj që shpejt  
Të vijë ajo ditë  
Ti të krenohesh  
Që isha nënësi yt.

*Aresa Kicaj, kl. II/2*

## 17 SHKURTI

Sa kohë ka kaluar  
Derisa erdhi kjo ditë  
Sa shumë njerëz janë flijuar  
Sa shumë kemi prit.

Plot sakrifica e mundime  
Plot vuajtje e padrejtësi  
Kaloi kjo Kosova ime  
Gjatë rrugës për pavarësi.

Vite e vite të tëra  
Trimat për liri luftuan  
Ditë e ditë të tëra  
Nën at për liri punuan.

*Dorela Beqiraj, kl. IV/1*

## 7 MARS

Mësues i dashur  
Mësues krenar  
Të kam dashur shumë  
Që nga klasa e parë.

Shkronjat e para  
Nga ti i mësova  
Mësues i dashur  
Shumë të adhurova.

Edukatë morëm  
Që nga klasa e parë  
Do të jemi shembull  
Dhe me faqe të bardhë.

*Rina Demaj, kl. V/2*

## 7 DHE 8 MARS

Janë dy festa  
Që i adhuroj  
Dhe asnjërën aspak  
Nuk e veçoj.

7 marsin me lule  
Mësuesit ia dhuroj  
Më 8 mars nënës  
Një përqaftim ia dhuroj.

Njëherë 7 marsin  
Mësuesit ia uroj  
Sepse më mësoj  
Dhe më edukoj.

Pastaj vjen 8 marsi  
Nënën e përqaftoj  
Dhe asaj me një dhuratë  
Festën ia uroj.

*Sara Kicaj, kl. V/2*

## MËSUESI IM

Mësues i dashur  
O sa fort të dua  
Me shumë mundim  
Më mësove mua.

Më mësove  
Të shkruaj e të lexoj  
Këshillat që na dhe  
Do t'i kujtoj.

*Elda Tafaj, kl. V/1*

## 7 DHE 8 MARS

Janë dy festa  
Që i adhuroj  
Dhe asnjërën aspak  
Nuk e veçoj.

7 marsin me lule  
Mësuesit ia dhuroj  
Më 8 mars nënës  
Një përqaftim ia dhuroj.

Njëherë 7 marsin  
Mësuesit ia uroj  
Sepse më mësoj  
Dhe më edukoj.

Pastaj vjen 8 marsi  
Nënën e përqaftoj  
Dhe asaj me një dhuratë  
Festën ia uroj.

*Sara Kicaj, kl. V/2*

## FESTA E MËSUESIT

Na erdhi dhe 7 marsi  
Oh sa gëzim  
Me lule e mbushi  
Gjithë vendin tim.

Fëmijët e vegjël  
Shumë të gëzuar  
Të gjithë vrapojnë  
Me buqeta në duar.

Të gjithë vrapojnë  
Kush e kush më parë  
Për t'i dhuruar lule  
Mësuesit sa më parë.

*Rina Beqiraj, kl. IV/1*

## MËSUESI

Dy duar të arta  
Shkronjat m'i mësovan  
Numrat dhe fjalët e gjata  
Që asnjëherë nuk  
u harruan.

Mësova shumë gjëra  
Fitova shumë njohuri  
Fjalët e para  
I mësova, mësues nga ti.

Përrallat ishin të bukura  
E këngët plot kuptim  
Gjithnjë unë e dua  
Të dashurin mësuesin  
tim.

Edhe kur të rritem  
Nëse dikush do të jem  
Fjalët dhe këshillat  
e mësuesit  
Gjithnjë do t'i kem.

*Verona Selimaj, kl. V/2*

## MËSUESES SIME

Mësuesen e dashur  
Unë shumë e dua  
Pas prindërve të mi  
Më e shtrenjtë për mua.

Për gjëra të bukura  
Gjithmonë na mëson  
Kur i kryejmë detyrat  
Na përkëdhel dhe ledhaton.

Mësuesen time  
Kurrë s'do ta harroj  
Ndër vjersha dhe tregime  
Unë do ta kujtoj.

Edhe kur të rritem  
Nëse dikush do të jem  
Fjalët dhe këshillat e tua  
Gjithmonë në mendje  
do t'i kem.

*Erion Kurtishaj, kl. II/2*



## STINËT

Erdhi pranvera me plot gëzim  
Lulet çelin në vendin tim.

Pastaj vjen vera  
me plot nxehtësi  
Që na sjell shumë begati.

Vjen vjeshta me stuhi  
Mbushen pellgjet plot me shi.  
Na erdh dimri me ftohtësi  
Fëmijët luajnë me kënaqësi.

*Anjeza Canaj, kl. V/2*





# KOPSHTI POETIK



## 7 MARS

Do të doja të gjej fjalë  
Që ty të të përshkruaj  
Veprat e tua do t'i çmoj  
gjithmonë  
Gjatë tërë jetës s'kam  
për t'i harruar.

Çdo sukses imi  
Do të jetë merita jote  
Nëse unë do të korr sukses  
Do të përmendet vepra jote.

Nuk gjej frazë të përshkruaj  
Dashurinë që kam për ty  
Nëse do të më thonin të  
të përshkruaj  
Do të thoja ty të kam hero.

Ti je hero i diturisë  
Që gjithmonë do  
të përmendim  
Falë teje o mësues  
Ne jemi këtu ku jemi.

*Blenard Lushaj, kl. V/1*

## 8 MARS

Sa herë vjen data tetë  
Për çdo vit në muajin  
e tretë  
Zgjohem herët në agim  
I mbledh lule mamit tim.

Si ylber me shtatë ngjyra  
Mamit tim i qesh fytyra  
Qofsh i lumtur biri im!  
Ti je rreze e shpirtit tim.

*Ledion Zenelaj, kl. IV/2*

## 7 MARS

Shtatë marsi po na vjen  
Tetë marsi po afron  
Le të mbledhim lule  
Për mësuesen tonë.

O mësuese e dashur  
Ne të duam shumë  
Ti për ne je nënë e dytë  
Se na edukon.

*Artin Canaj, kl. IV/2*

## NËNËS

Jam ende i vogël  
E ndonjëherë gaboj  
Po ta dish o nënë  
Se ty të adhuroj.

Ti më je e dashur  
Gjithmonë më kupton  
Në çdo hap të jetës  
Mua më këshillon.

Dhe emrin tënd nënë  
Sa herë e thërras  
Zemra më gëzohet  
E buza vihet në gaz.

*Rinor Selimaj,  
kl. IV/2*

## YJET E LIRISË

O dëshmorët e fshatit  
Bijtë e këtij dheu  
Gjënë më të shtrenjtë  
Ja falët atdheut.

Në bjeshkët e Pashtrikut  
Në vendin kufitar  
Trimat e Greikocit  
Na ranë dëshmorë.

S'e kursyet jetën  
As ditën e as natën  
Këtë tokë të bekuar  
Që e latë me gjak.

Ju dëshmorët  
Që nuk deshët robëri  
Me gjakun tuaj  
Shkruat emrin LIRI.

Sa mali e shkëmbi  
Rrofsh mburoja jonë  
Farkuar ndër beteja  
Paç lavdi gjithmonë!

*Ylljeta Kicaj, kl. VII/2*

## MËSUESI IM

Fjalën mësues  
Unë e adhuroj  
Ti më mësove  
Të shkruaj e të lexoj.

Festën tënde mësues  
Nuk do ta harroj  
Fytyra jote e qeshur  
Mua më gëzon.

Do të shkruaj vjersha  
Për vite me radhë  
Ti në zemrën time  
Do të jesh gjithmonë.

*Aulon Haxhaj, kl. V/1*

## DËSHMORËVE

O ju dëshmorë  
Që dhatë jetën për liri  
Sot ne do t'ju kujtojmë  
Me shumë krenari.

Ju luftuat që ne  
të jemi të lumtur  
Në Kosovën e lirë  
Në shtet të pavarur  
Të jetojmë më mirë.

*Rinesa Kicaj, kl. VI/2*

## XHAXHAI IM

Jam shumë krenare  
Që të kam xhaxha  
Momente të lumtura  
Me ty kaloj  
Buzëqeshjen tënde  
Asnjëherë  
Nuk mund ta harroj.

Mos pyet  
Pse të dua  
Je pjesë  
E ëndrrave të mia  
Dashurinë tënde  
Askush nuk mund  
Ta zëvendësoj  
Me këshillat tua  
Unë lart shkoj.

*Mimoza Tafaj,  
kl. VIII/1*

## NËNA

Nëna ime e dashur  
Sa shumë unë të dua  
Sepse ti je ajo  
Që më linde mua.  
Ti je si yll  
Që gjatë natës shndërrit  
Ti je si hëna  
Që natën na e bën ditë.

Ti je ajo për të cilën  
Unë kam nevojë  
Ti je gjëja më e shtrenjtë  
Që Zoti ma dhuroj.

Ti je ajo që më rrite  
Dhe më edukove  
Ti je ajo që për mua  
Jetën ma ndryshove.

*Fitore Selimaj, kl. VIII/1*



## VERA

E nxehtë pors i zjarr  
E ëmbël pors i mjaltë  
Gjethet e saj të gjelbruara  
Lulet e saj të ngjyrosura  
Të bukura pors i ar.

*Jonila Beqiraj,  
kl. V/2*

## 17 SHKURTI

Kosovë e dashur, Kosovë krenare  
Shpalle Pavarësinë pa u trembur fare  
Gjaku i dëshmorëve derdhur për liri  
Ishte çmimi i madh për të shtrenjtën liri.

Kosovë e dashur, Kosovë heroinë  
Ngrite flamurin me shumë gëzim  
Sa dëshmorë ranë në altarin e lirisë  
Për këtë ditë të madhe të pavarësisë.

*Granit Kicaj, kl. VI/1*



# KOPSHTI POETIK



## XHAXHAIT TIM

Sot u bënë 17 vjet  
Pa ty i dashuri xhaxha  
Dua të vij te varri  
Të të vizitoj  
Por ti vetëm më dëgjon  
E nuk më flet dot  
Shpirti yt më shikon  
Në qiell afër të të madhit  
Zot.

Shikoj yjet dhe them  
Atje është edhe xhaxhai im  
Ah, sikur të kem mundësi  
T'i hidhesha në përqaftim.

Kudo që jeni  
Kudo që shkojmë  
Nga zemrat e vuajtura  
Jo kurrë s'të largojmë.

Të kujtojmë me mall  
Pikëllim e mërzi  
Të qoftë dhe i lehtë  
Aty ku pushon TI.

*Riona Tafaj, kl. IX/1*

## 28 NËNTORI

Data 28 nëntor  
Një ditë e shënuar  
Festë e madhe është në Vlorë  
Të gjithë me flamur në duar.

Shqiptarët anembanë  
Do të sulen drejt Shqipërisë  
Të festojnë për shtetin  
shqiptar  
100 vjetorin e Pavarësisë.

E tërë bota na ka zili  
Për këtë të bukurën Shqipëri  
Që është më e fortë se kurrë  
Janë bashkuar për të njëjtin  
flamur.

*Rita Curraj, kl. V/1*

## 7 DHE 8 MARS

Dy festa të bukura  
Të prindërve të mi  
Njëra në shkollë  
E tjetra në shtëpi.

Njëra e mësueses  
Tjetra e nënës  
Të dyja shkëlqenin  
Si drita e hënës.

7 marsi në shkollë  
8 marsi në shtëpi  
Të dyja i çmoj  
Festat ua uroj.

*Eriola Beqiraj,  
kl. II/1*

## PRANVERA

Hiqet bora  
Vjen pranvera  
Këndon bilbili  
Si herat e tjera.

Era vjen kudo që të shkosh  
Çelin lulet nëpër kopsht.  
Një aromë po kundërmon  
Disa lule po lulëzojnë  
Qielli i kaltër është hapur  
Të gjithë zogjtë po fluturojnë.

Ta shijojmë edhe ne këtë ditë  
Që me muaj e kemi prit  
Të gëzuar të jetojmë  
Dhe natyrën ta shfrytëzojmë.

*Eliza Shahinaj, kl. V/1*

## DITË E PAHARRUAR

Ditë e paharruar  
Për kombin shqiptar  
Momentet më të bukura  
I mbyllim në sirtar.

Sa vuajtje, sa mjerim  
Sa lot për të gjetur shpëtim  
Sa përpjekje nga armiqtë  
Për ta shtypur vendin tim.  
Duart drejtuar Zotit  
Nëna me lot në sy  
Lutej duke vajtuar  
Për mua, për ty.

Lotët s'patën mbarim  
Prapë qeshin fytyrat tona  
Edhe pse trimat s'patën kthim  
U çlirua e imja Kosova.

*Agona Shahinaj, kl. VII/1*

## LIBRI IM

Librin tim unë  
Shumë e dua  
Vjersha, përralla  
M'i mësoj mua.

Më mësoj të lexoj  
Të shkruaj ABC  
Libri im i dashur  
Të dua gjithnjë.

*Etleva Beqiraj,  
kl. III/1*

## KOSOVA

Kosova jonë e dashur  
E vranë dhe e djegur  
Atdhe i robëruar  
I shkelur ndër shekuj.

Shumë bijë e bija  
I dhe për këtë ditë  
Që për shekuj me radhë  
Të gjithë e kemi prit.

Armikut të zi  
Në fyt ia vumë frikën  
Që për vite e gjenerata  
Në vranë e na mbytn.

Sot, Kosovë e bukur  
Si lule po lulëzon  
Sot për Ty ky diell  
Më bukur po rrezon.

Atdhe që këpute prangat  
Që me gjak fitove lirinë  
Sot të bashkuar si  
asnjëherë  
Festojmë pavarësinë.

*Leonita Kicaj, kl. VII/2*

## BACI HAZIR

Trim shqiptar  
Hazir Selimaj  
Që dha jetën për liri  
E dha gjakun për Shqipëri.

Luftoi baci Hazir  
Me shumë luftëtarë  
I doli armikut ballë  
për ballë  
Për vite të tëra do ta  
kujtojmë  
Emri yt, baci Hazir,  
Gjithmonë do të rrojë.

Ai dha gjakun për liri  
Që ne ta gëzojmë këtë  
pavarësi  
Pavarësinë ta festojmë  
Dëshmorët e kombit  
t'i kujtojmë.

*Redon Selimaj, kl. III/1*

## PSE

Pse njerëzit gënjejnë  
Pse s'pajtohen me të vërtetën  
Pse ia bëjnë varrin njëri-tjetrit  
E nuk merren me vetveten.

Pse bota është e tillë  
Kur në të ka njerëz të mirë  
Ka të ditur dhe me vlerë  
Që populli i do gjithherë.

*Melisa Lushaj, kl. VIII/1*

# FILLET E MUZIKËS SË KULTIVUAR ARTISTIKE SHQIPTARE

Megjithëse populli shqiptar është ndër popujt më të vjetër të Ballkanit e të Evropës dhe i dalluar për talent dhe dashuri të madhe për muzikën, që këtë e dëshmon folklori shumë i pasur muzikor. Muzika e kultivuar-artistike zhvillohet shumë më vonë se sa muzika artistike evropiane. Shkaqet e kësaj vonese evidente mbështeten në faktet e njohura historike. Populli shqiptar shekuj me radhë ka vuajtur (gjysma e tij edhe sot vuan) nën sundimin e të huajve. Është populli i fundit i Ballkanit dhe i Evropës që fitoi pavarësinë nga Turqia më 1912. Muzika e kultivuar shqiptare nuk e kishte mundësinë dhe fatin që të zhvillohet normalisht si te popujt e përparuar evropian, sepse i mungonte kushti kryesor - liria. Ajo nuk njohu stilet e epokave të ndryshme nëpër të cilat kaloi muzika evropiane. Nuk kishte krijimtari dhe kompozitorë të renesancës, madje as kompozitorë e vepra të stileve të barokut, as të stilit klasik. Edhe stili i muzikës romantike paraqitet mjaft vonë, gati një shekull pas muzikës romantike evropiane. Hapat e parë të muzikës së kultivuar artistike shqiptare u paraqitën në mbarimin e shekullit XIX në etapën e fundit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Veprimtaria muzikore me aktivitete amatore nëpërmjet shoqatave e klubeve që do të themelohen nëpër qytetet më të mëdha shqiptare, si: Shkodra, Elbasani, Korça, Durrësi, Shkupit e Prizrenit, do të jetë bazë për formimin e ansambleve muzikore. Ansambli, përkatësisht orkestra e parë muzikore është orkestra frymore (banda), e cila u themelua në qytetin e Shkodrës në vitin e madh të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 1878. Ky ansambël - orkestër frymore në fillim kishte 31 anëtarë e më vonë numri do të shtohet, madje do të formohen edhe orkestra të tjera të kësaj natyre. Kjo orkestër, si edhe të tjerat, që do të pasojnë, jo vetëm në qytetin e Shkodrës, por edhe në qytete të tjera shqiptare, formohet me angazhimin e patriotëve entuziastë, të cilët edhe do të financojnë aktivitetet muzikore. Disa vite më vonë, në Shkodër, formohen edhe shoqëri të tjera artistike kulturore, siç janë: "**Vllaznia**", me drejtuesit Zef Kurti e Luigj Perla. Pasojnë shoqëritë: "**Rozafa**", "**Iliricum**", "**Bogdani**".

Në drejtimin muzikor të këtyre shoqërive do të angazhohet kompozitori, **Martin Gjoka**. Nismëtarët e dirigjimit të orkestrës frymore, të parës në mesin e shqiptarëve në Shkodër ishin kompozitorët: **Palok Kurti**, **Thoma Nasi** dhe **Frano Ndoja**, që kontribuan për muzikën tonë artistike.

*Ardhmërie Baraliu, prof. e artit muzikor*

# ARTI ËSHTË FRYMËZIM PËR TË KRIJUAR VEPRA ARTISTIKE

Lënda e artit figurativ, si fushë më vete, ka rëndësi të veçantë për nxënësit, por edhe artdashësit i jep një vullnet edhe frymëzim për të krijuar vepra artistike.

Edukata figurative në shkollat fillore jep një kulturë edhe mësim për ngjyrat, kombinimin e tyre, ndarjen, si edhe efektin psikologjik në jetën e përditshme.

Nxënësit duhet të mësojnë sidomos për teknikat e vizatimit, llojet, si dhe për efektin e saj, si p.sh: Lapsi, Thëngjilli, Tushi, Akuareli, Bajci, pastaj çka është

**Skica, karikatura, kroki, vinjeta dhe kartoni.**

Arti figurativ përfshin shumë tema të ndryshme, si: Skulpturën, grafikën, pikturën, dizajnin me komunikimet vizuale, elementet figurative.

Me proces estetiko - kreativ, në orën mësimore, nxënësit duhet të përkushtohen në punën e tyre, sidomos me laps dhe teknikat e ngjyrave. Te punohet me kontrastet e vijave të lapsit dhe gjatë pikturimit të përdorin ritmin dhe teknikën e brushës dhe ta shfrytëzojnë hapësirën, sipas formës që ka figura.

*Fahri KUKAJ, prof. i artit figurativ*

# ADOLESHENTËT JETOJNË ME MITIN E TEKNOLOGJISË

Përdorimi i kompjuterit dhe i internetit mes adoleshentëve, nga viti 2000 e deri më sot është rritur në mënyrë konstante e të



vazhdueshme.

Fatkeqësisht me përdorimin e shumë të internetit është shtuar dhe rreziku për të përdorur sjellje të pahijshme. Shkëmbejnë me njeri-tjetrin numra telefonash, fotografi (edhe provokuese) dhe janë gati të takohen edhe me të panjohur. Ndryshe nga dikur, sot është shtuar koha që kalojnë në internet.

Adoleshentët nuk e kuptojnë rrezikun që u kanoset duke çatuar në internet. Sigurisht që bashkëbiseduesit, në anën tjetër, mund të jenë adoleshentë, por kjo gjë nuk e ul aspak rrezikun.

Nëse prindërit do të ishin më të kujdesshëm me fëmijët e tyre dhe nuk do t'i lejonin ata të kalonin shumë kohë në internet, atëherë adoleshentët do të mësoheshin me rregull dhe kërkesë llogarie.

Por, edhe heqja e internetit ka avantazhet dhe disavantazhet e veta. Për shembull, nëse adoleshenteve do t'u ndalohej navigimi në internet, atëherë ato do t'i riktheheshin televizorit, duke mos ia ndarë sytë për orë të tëra në ditë. 23% e adoleshentëve shohin televizor mbi tri orë në ditë. Nga përgjigjet e të intervistuarve, 7 për qind e adoleshentëve ka deklaruar se e kalon kohën para televizorit e internetit. Pra, në bazë të përgjigjeve, dimë se shumë të rinj kalojnë mesatarisht 4-5 orë në ditë para ekranit të një monitori.

## Facebook

Rrjetet sociale janë bërë pjesë e jetës së përditshme për 60% të shqiptarëve. Statistikat flasin për një përdorim të gjerë, kryesisht të facebook, por edhe të Twitter, my space, blogger, netlog etj. Përdoruesit janë të moshave të ndryshme, duke filluar që nga adoleshentët e deri te personat mbi 50-vjeç.



Por, a përbën problem përdorimi i këtyre rrjeteve?

A duhet të shqetësohen prindërit për fëmijët e tyre?

Më poshtë po ju japim disa fakte mbi efektet, që kanë rrjetet sociale për shëndetin tuaj.

### Efektet pozitive

#### 1. Nxiti vetëvlerësim

Sipas një studimi që është bërë, ata të cilët përdorin facebook-un dhe i përditësojnë statuset e tyre, ndjeheshin më mirë dhe janë neëhumor më të mirë, krahasuar me ata, që nuk e kanë përdorur fare.

Sipas studiuesve, përdorimi i statuseve apo postimet, nxisin konfidencën, besimin dhe famën për vetveten.

#### 2. Forcon marrëdhëniet shoqërore

Facebook ndihmon në forcimin e marrëdhënieve midis miqve.

Si mesazhet private (inbox) apo "wall post" i jepnin mundësi përdoruesve të

besojnë te miqtë e tyre, t'i rikthehen kujtimeve të vjetra e të qeshin me zë të lartë.

### Efektet negative

1. Shkakton depresion. Kjo ndodh kur ka një përdorim të pakontrolluar dhe të pakufizuar të facebook, veçanërisht nga adoleshentët, të cilët mund të shfaqin edhe sjellje agresive. Megjithëse, ky fenomen ende nuk është vërtetuar shkencërisht dhe, në fakt, ekspertët pohojnë se kjo është pak a shumë një lidhje e ndërsjellët. Janë personat depresivë më të prirur që të përdorin facebook-un.


Në përgjithësi, përdoruesit e rinj janë më të pritur të shpenzojnë më shumë kohë në facebook, sa të familjarizohen, në krahasim me ata, që kanë kohë që e kanë hapur profilin e tyre. Depresioni nuk vjen nga përdorimi i facebook-ut, por nga marrëdhëniet e dobëta me miqtë apo familjarët.

2. Çrregullon mënyrën e ushqyerjes. Sa më shumë të rrinë adoleshentët në facebook apo rrjetet të tjera sociale, aq më shumë janë të pritur për çrregullime në mënyrën e të ngrënit, duke degraduar deri në anoreksi, bulimi apo dieta ekstreme.

Por, jo, domosdoshmërisht për këtë është fajtor facebooku. Ndoshta, është e kundërta, që personat me këto çrregullime shpenzojnë më shumë kohë online. Duhet të tregohet një

kujdes i veçantë nga ana e prindërve, që të kufizojnë efektet negative, jo vetëm të facebook-ut, por të mediet në përgjithësi, te fëmijët e tyre.

“ Shpresojmë që në të ardhmen të mos e kontrollojë teknologjia jetën e adoleshentëve, por adoleshentët teknologjinë dhe rrjetet sociale”.



I madhi Anjshajtani ka thënë:

*“ I fiksohem ditës kur teknologjia do të tejkalojë çdo gjë, madje dhe bashkëveprimin mes njerëzve.*

*Kur të vijë ajo ditë, ne do të kemi një gjeneratë më idiote”.*

*Përgatiti:*

*Hashim Kukaj, arsimtar i Teknologjisë*

## Humor

### MBIEMRI

Arsimtarja e gjuhës shqipe pyet: - Genti, na flet për mbiemrin?

- Mbiemri im është Rrustemi. Ai u vra si luftëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe në shenjë respekti ndaj gjyshit e mbaj mbiemrin sot.

- Ju lutem unë pyeta çka quhet mbiemër e jo të flisni për të.

- Arsimtare në këtë rast mbiemër quhet “Rrustemi”.

### QORTIMI

- Dy gjëra nuk po të lënë të luash mirë futboll, - e qortoi Fidani shokun e vet.

- Po thuaj, ore, cilat janë ato gjëra? – u interesua ai.

- Dy këmbët e tua!

### TALLJA

Fidani u zgjua vonë dhe meqë ishte vonuar për në shkollë, u përgatit shkel e shko dhe kur vajti në shkollë – shokët dhe shoqet u tallën:

-Uuu, Fidan, po përse ke mbathur një këpucë të kuqe e tjetrën të zezë?

Ai i hutuar, mendoj pak dhe tha: - E, pra, për çudi, edhe në shtëpi i kam një palë të ngjashme.

### PATKOI

Genci kishte gjetur patkoin e kalit diku në rrugë.

- A e di ti, Gimi, - iu drejtua ai shokut të vet, - çka do të thotë të gjesh patkoin e kalit?

- Do të thotë se kali do të ecën zbathur! – u përgjigj Gimi.

*Zgjedhi: Sami Baraliu*

# FJALËKRYQI

|    | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 |
|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----|----|----|----|----|----|
| 1  |   |   |   |   |   |   |   | ■ |   |    |    |    |    |    |    |    |
| 2  |   |   |   |   |   |   |   |   |   | ■  |    |    |    | ■  |    |    |
| 3  |   | ■ |   |   |   |   |   | ■ |   |    | ■  |    |    |    |    |    |
| 4  |   |   |   | ■ |   | ■ |   |   |   |    |    | ■  | ■  | ■  |    |    |
| 5  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |
| 6  |   |   |   |   |   |   |   | ■ |   | ■  |    |    |    |    |    |    |
| 7  |   | ■ | ■ |   |   |   |   |   |   |    |    | ■  |    |    |    |    |
| 8  |   |   |   |   | ■ | ■ |   |   |   | ■  |    |    |    |    |    |    |
| 9  |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    | ■  |    |
| 10 |   |   | ■ | ■ |   |   |   |   |   |    |    |    |    | ■  | ■  |    |
| 11 | ■ |   |   | ■ |   |   |   | ■ |   |    | ■  |    |    |    |    |    |
| 12 |   |   |   |   |   | ■ |   |   |   |    |    |    | ■  | ■  |    |    |
| 13 |   |   | ■ | ■ |   |   |   |   |   | ■  |    |    |    |    |    | ■  |
| 14 |   |   |   |   |   | ■ |   | ■ |   |    |    |    |    |    |    |    |
| 15 |   |   |   |   |   |   | ■ | ■ |   |    |    | ■  |    |    |    |    |
| 16 |   |   |   |   |   |   |   |   |   |    |    |    |    |    |    |    |

## HORIZONTALISHT:


1. Qytet bregdetar shqiptar – tërësia e shkronjave të një gjuhe, të radhitura sipas një rendi të caktuar; 2. Shqyrtoj njerëz, sende, dukuri, mendime etj. në lidhje me njëri-tjetrin për të nxjerrë ngjashmëritë, dallimet e veçoritë e tyre – tokë e punueshme – dy bashkëtingëllore; 3. Zanore jona – emër boshnjak – notë muzikore – lloji alkooli; 4. Emri që i del dikujt për të mirë ose për të keq – emër femre shqiptare – bashkëtingëllore jona; 5. Organi drejtues i një institucioni – emision në KTV me Adriatik Kelmendin; 6. Emër femre shqiptare – zanore jona – emër mashkulli; 7. Bashkëtingëlloja e 24-të e gjuhës shqipe – një shtet – bimë barishtore e butë me kërcell të degëzuar; 8. Ai që kullot e ruan bagëtinë, çoban – lumë në Austri – këngëtare shqiptare me famë botërore; 9. Energjia bërthamore, nukleare – bashkëtingëllore; 10. Zanore jona, shkronja e 30-të e alfabetit shqip – lumë në Gjakovë (trajta e pashquar) – shkruaj DA; 11. Përemër vektor – shkruaj VAE – zanore jona – emri i aktorit të mirënjohur shqiptar, tashmë i ndjerë, Luca; 12. Strehë për t'u mbrojtur nga dielli apo nga moti i keq, çadër – bimë barishtore e vendeve tropikale – element kimik; 13. Pashthirmë – pjesa përdhese e një shtëpie ku mbahen kafshët dhe ushqimi i tyre – gjiri i vogël në breg të detit – bashkëtingëllore, shkronja e 30-të e alfabetit të gjuhës shqipe; 14. Kafshë e vogël gjitare, me turi të zgjatur, me këmbët e para si lopatë, që jeton nën tokë – zanore jona – ndërtesë a vend i posaçëm ku është vendosur aparati kinematografik dhe shfaqen filma; 15. Emri i dëshmorit Sinani (trajta e pashquar) – shkruaj PEP – AMAJ; 16. Metoda studimi ku anët e veçanta përmblihen e përgjithësohen, zberthim në pjesët e veta përbërëse.

## VERTIKALISHT:

1. Hero yni kombëtar – emri i mbretëreshës së fisit ilir të ardianëve; 2. Metal i rrallë, i çmuar, me ngjyrë të verdhë – ARR – AN – kryeqyteti i Iranit (e pashquar); 3. I ndjerë (turqisht) – notë muzikore – lumë në Austri – IHA; 4. Pashthirmë, përdoret kujtohemi papritur – i marrë peng (turqisht) – DATHIL; 5. Ai që flet në vetën e tretë dhe e sheh ngjarjen nga jashtë – gur i çmueshëm, diamant brilant; 6. DSI – emër mashkulli – IRA – zanore – bashkëtingëllore; 7. Dy kontinente; 8. Zanore, shkronja e parë e alfabetit shqip – bashkëtingëllore – ANAN – përemër vektor – EDH; 9. Emër mashkulli – Sheshi kryesor në Kinë – KPE; 10. Bashkëtingëllore – INU – rrëshqanor i madh, me trup deri në gjashtë metra të gjatë, me kokë të shtypur, që jeton në ujërat e vendeve tropikale – bashkëtingëllore; 11. Notë muzikore – GBEATIM- emër përkëdhelës i emrit Fatlind; 12. Dyzet (arabisht) – përemër vektor – emri (anglisht) – bashkëtingëllore; 13. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të hollë e të njomë ( e pashquar) – ai që kosit barin – bashkëtingëllore – mbretëresha e bletëve; 14. Zanore – shkronja e parë e alfabetit tonë – ORPOE – bashkëtingëllore – emër (anglisht); 15. Dhjetë (anglisht) – NIER – hapësirë shumë e madhe me ujë të kripur, që zakonisht është i rrethuar me tokë – vijë a hendek i vogël, që shpie ujën në mulli, në arë etj.; 16. Dëshmori dhe heroi i luftës së UÇK-së i ardhur nga Shqipëria.

*E përpiloi: Tahir ZENELAJ*

# KËNDI I NXËNËSVE PARASHKOLLORE





**BOTIMIN E KËTIJ NUMRI E SPONSORIZOI SHOQATA "GREIKOCI"  
ME SELI NË KLEINDÖTTINGEN AG - ZVICËR**